



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:153301

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06380438

C.nr.2782/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.Q. me numër personal nga fshati Xërxë, Komuna e Rahoveci, të cilin me autorizim e përfaqëson A.Th. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës P.K.-Drejtoria e Përgjithshme, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me adresë ish Pallati i Rilindjes, Prishtinë, me objekt të padisë kompensimi i pagës së trembëdhjetë (13), vlera e kontestit 877,52 €, jashtë seance, me datë **31.10.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit Sh.Q. nga fshati Xërxë, Komuna e Rahoveci, ashtu që **DETYROHET** e paditura P.K. që paditësit, në emër të kompensimit të pagesës së trembëdhjetë për vitin 2021, t'ia paguaj shumën në lartësi prej 877,52 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 29.05.2024, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. **DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 124.00 € (njëqind e njëzetekatër), në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi paditësit Sh.Q. nga fshati Xërxë, Komuna e Rahoveci, përmes të autorizuarit të tij A.Th. avokat nga Prizreni, me datën 29.05.2024, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës, P.K. Drejtoria e Përgjithshme, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore të Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e pagës së trembëdhjetë për vitet 2021, në shumë prej 877,52 €.

Sipas të autorizuarit të paditësit, paditësi Sh.Q. është i punësuar me orare të plotë në Policinë e Kosovës, që nga data 24.09.2001 dhe merr pagë të rregullt mujore në lartësi prej 998.20 euro. Paditësi, si i punësuar në Policinë e Kosovës, duke u mbështetur në Ligjin e Punës nr.03/L-2012, nenet 55 dhe 59, Ligjin për Policinë e Kosovës, nenet 44 dhe 45, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.4/2017, Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, sipas nenit 29 par.2, i takon të përfitojnë shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt në fund të vitit. Paditësi e ka plotësuar këtë kusht, respektivisht ka treguar performancë shumë të mirë gjatë vitit 2021. Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, i është drejtuar MPB/Policia e Kosovës/Drejtoria e Përgjithshme/ Drejtoria për Personel, me kërkesë për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, e cila kërkesë është refuzuar me arsyetimin e mungesës financiare. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoje në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në padi, ku ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, pasi që paraprakisht nuk është bërë shterja e mjeteve juridike nga ana e paditësit, si dhe ka skaduar afati për paraqitjen e padisë nga paditësi në gjykatë. Ndërsa sa i përket kërkesës për pagën e 13-të, e ka kundërshtuar pasi që kjo kërkesë nuk është realizuar për asnjë punonjës së Policisë së Kosovës për shkak të mjeteve financiare, po ashtu thekson se e paditura edhe pse ka kërkuar mjete financiare nga Ministria e Financave, e njëjta nuk ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës, ashtu që në mungesë së mjeteve buxhetore nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Nga gjithë të thënat ka theksuar se padia nuk ka bazë ligjore ngase e paditura vlerëson se ka përmbushur detyrimet ligjore nga marrëdhënia e punës e paraparë me kontratën e punës, e cila konsiderohet ligj për palët. Andaj, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa themeltë.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi që nga data 21.09.2001, është në marrëdhënie pune pranë të paditurës.

Gjykata përmes vërtetimit të punësimit me numër të referencës 07/1-01SR/524/2024 I DATES 20.05.2024, vërtetoi faktin se paditësi që nga data 24.09.2001, është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 877.52 euro në muaj. Po ashtu përmes formularit të vlerësimit të performancës për vitin 2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka pasur

vlerësim të përgjithshëm, me notën 4, që korrespondon me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm.

Vërtetimin si dhe formularin e lartcekur, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj vërtetimit me të cilin është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe lartësia e pagës mujore të tij, si dhe formularit me të cilin është bërë vlerësimi i punës së paditësit për vitin kalendarik 2021, Gjykata ia fali besimin e plotë. Gjykata vlerëson se edhe pse formulari për vlerësimin e performancës i vitit 2021, nuk është i nënshkruara dhe i vulosur, të njëjtit ia fali besimin e plot për faktin se me përgjigjen në padi, e paditura nuk e ka kontestuar të njëjtin, ndërsa nëpërmjet emalit të pranuar nga zyrtarët e policisë është sqaruar procedura e vlerësimit *“pas aprovimit nga i Vlerësuari forma e vlerësimit të performancës kalon të Mbikëqyrësi me i lartë për Aprovim dhe nga momenti i aprovimit sistemi vetvetiu e vendos emrin e tij pozitën dhe datën në formën e vlerësimit dhe këto të dhanë janë nënshkrimi i zyrtarit sepse nga ky moment vlerësimi konsiderohet i përfunduar”* me çka mund të konstatohet se vlerësimi i paraqitur është i saktë dhe i bërë nga ana e të paditurës.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076, për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021, i datës 29.09.2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku përcaktohet se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*. Në nenin 44 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076, për Policinë përcaktohet se: *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*. Ndërsa neni 55 par.1 nënpar.1.7 i këtij Ligji përcakton se: *“Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*.

Në nenin 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përcaktohet se: *“Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*, ndërsa në pikën 1 të këtij paragrafi parashihet *“zyrtarët policorë që bëjnë betimin dhe të cilët kanë autoritet t'i ushtrojnë autorizimet dhe detyrat policore”*.

Ndërkaq në nenin 29 paragrafi 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Po ashtu në nenin 6 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021, të datës 29.09.2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përcaktohet se: *“Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*, ndërsa në pikën 1 të këtij paragrafi parashihet *“zyrtarët policorë që bëjnë betimin dhe të cilët kanë autoritet t’i ushtrojnë autorizimet dhe detyrat policore”*. Ndërkaq në nenin 30 paragrafi 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13 për çdo fund vit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, si dhe në nenin 30 paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021, i datës 29.09.2021, më saktësisht, vlerësimi për vitin 2021, ka qenë me notën 4, që korrespondon me vlerësimin plotësisht të kënaqshëm, e po ashtu ndaj të njëjtit gjatë këtyre viteve nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit për këtë pjesë është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 dhe Nr.01/2021, i datës 29.09.2021, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor. Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës se padia në gjykatë është paraqitur pas skadimit të afatit të paraqitjes së padisë, mirëpo këto pretendime i vlerësoi si të pabazuara, kjo pasi që kërkesa e paditësit është për kompensimin e pagës së 13-të, për vitin 2021, e cila pagë

bazuar në udhëzimet e lartcekura duhet të paguhet në fund të vitit, ndërsa paditësi padinë e ka paraqitur me datë 29.05.2024, pra brenda afatit prej 3 viteve të paraparë në nenin 87 të Ligjit të Punës, i cili ka përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Meqenëse e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata ka vendosur që kamatë vonesa të jetë prej 8%, duke u bazuar në nenin bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (29.05.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020, të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 € dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 €.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 2782/2024, datë 31.10.2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.